



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR

Nr. 6646 Prot

Shkodër, më 26.03.2025

**DËRGIM PROJEKT - VENDIM DHE RELACION  
KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER**

Të nderuar këshilltarë !

Bashkangjitur ju dërgojme projekt-vendimin dhe relacionin shpjegues " Per shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 76, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër", i ndryshuar.

Duke ju uruar punë të mbarë !

Me respekt.

Ky projekt-vendim dhe relacion përmban këtë dokumentacion:

- Shkresë përcjellese 1 (një) Fletë
- Projektvendim 3 (tre) Fletë
- Relacion 3 (tre) Fletë

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV. KRYETAR

Alban PREKA





REPUBLIKA E SHOIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_ 03.2025

**PROJEKT- VENDIM**

**"PËR SHTESE NË BUXHETIN E VITIT 2025 E MIRATUAR ME "VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.76 DATE 19.12.2024 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2025- 2027 TË BASHKISË SHKODËR" I NDRYSHUAR.**

Këshilli i Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_ .2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 54 shkronja "dh"; ligji nr.45/2019 "Per Mbrojtjen Civile", VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKM nr.414 date 08.07.2021 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" i ndryshuar, neni 3,3.1, gërmat a,b,dh, ligji nr.68/2017 "Për financat vendore" i ndryshuar, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriterët dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, shkresës nr.492/1 prot. datë 25.02.2025 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" të Ministrisë së Mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile"; shkresës nr.4804/1 prot. datë 28.02.2025 "Kthim përgjigje Ministrisë së Mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të shkresës me nr. 492/1 prot. date 25.02.2025 me objekt "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" nga Bashkia Shkodër ; shkresës nr.4804/1 date 28.02.2025 prot. "Dergohet miratimi për shpërdarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2025" të Ministrisë së Financave VKB nr. 76 , date 19.12.2024 "Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2025-2027 te Bashkisë Shkodër", i ndryshuar , dhe "Relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Shkodër nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ .

## VENDOSI:

I. Të miratoje shtesën e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2025 alokuar në programin AB141 –Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile, art.604 prej 21,907,271.74 lekë e detajuar si më poshtë:

1. Për Kod produkti 91707AG - "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve", vlera e përlllogaritur është **6,000,000 lekë**.

2. Për Kod produkti 91707AB- "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme ", vlera e përlllogaritur është **15,907,271.74 lekë**.

II. Te miratoje shpenzimet per marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese ne objekte te ndryshme, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve" me kod produkti 91707AG me vlere 6,000,000 leke si me poshte:

1. "Shërbime për mirëmbajtje emergjente te rrugëve te Qytetit dhe Njesive Administrative, Bashkia Shkoder" me vlere **6,000,000 lekë**.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI


- ZV.KRYETAR

Alban Proka 


- DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT FINANCIAR

Carota Hoxha 

- DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE , BURIMEVE NJEREZORE DHE  
SHERBIMEVE MBESHTETESE

Deris Veshori 

- DREJTORIA JURIDIKE

Marjeta Tushaj 

- DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Xhelmet Xhani 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
DREJTORIA EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_03.2025

RELACION

"PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2025 E MIRATUAR ME "VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.76 DATE 19.12.2024 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2025- 2027 TË BASHKISË SHKODËR" I NDRYSHUAR.

KESHILLIT BASHKIAK SHKODER

Të nderuar Këshilltarë,

Me shkresën nr.492/1 prot. datë 25.02.2025 Mbi fondin e kushtezuar te Buxhetit te shtetit për mbrojtjen civile" te Ministrisë së mbrojtjes, Agjensise Kombetare te Mbrojtjes Civile", eshte kerkuar ndarja e fondit te miratuar ne masen 21,907,271.74 lekë.

Me shkresën nr.4804/1 prot. date 28.02.2025 "Kthim përgjigje shkresës me nr. 492/1 prot. datë 25.02.2025 me objekt "Mbi fondin e kushtëzuar te Buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile" te Ministrise se Mbrojtjes, Agjensise Kombetare te Mbrojtjes Civile", Bashkia Shkoder ka bërë detajimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit per mbrojtjen civile per vitin 2025 si më poshtë:

1. Për Kod produkti 91707AG - "Shpenzime per marrjen e masave parandaluese, lehtesuese mbrojtese dhe rehabilituese ne objekte te ndryshme, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerezve ", vlera e përlllogaritur është **6,000,000 lekë** .

2. Për Kod produkti 91707AB- "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme ", vlera e përlllogaritur është **15,907,271.74 lekë**.

Propozojme miratimin e shteses se fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile per vitin 2025 ne vleren 21,907,271.74 lekë.

Me shkresën nr.492/1 date 25.02.2025 prot. "Dërgohet miratimi per shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2025" te Ministrisë së Financave është akorduar fondi prej 21,907,271.74 lekë.

Në mbështetje te nenit 23 të ligjit nr.139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr.45/2019 "Per Mbrojtjen Civile", VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetore financiare per mbulimin e dëmeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore", Udhëzimi i perbashkët i Ministrise së Brendshme dhe Ministrise së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Per kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmes shtetore financiare, per mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqesi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore", VKM nr.414 datë 08.07.2021 "Per miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të perdorimit të fondeve të kushtezuar te buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" i ndryshuar, neni 3,3.1, germat a,b,dh, ligji nr.68/2017 "Për financat vendore" i ndryshuar, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Per procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar; shkreses nr.492/1 prot. date 25.02.2025 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" të Ministrise së Mbrojtjes, Agjensisë Kombetare të Mbrojtjes Civile"; shkresës nr.4804/1 prot. date 28.02.2025 "Kthim pergjigje Ministrise se Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të shkresës me nr. 492/1 prot. datë 25.02.2025 me objekt "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile" nga Bashkia Shkoder . "Dergohet miratimi per shpërndarjen e fondit per Emergjencat Civile viti 2025" te Ministrisë së Financave "VKB nr. 76, date 19.12.2024 "Per miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkoder" , i ndryshuar, ju paraqesim propozimet si me poshte:

a. "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" kod produkti 91707AB me vlerë **15,907,271.74 lekë**. Ky fond të jete gjendje per perballimin e dëmeve të vlerave ndërtimore dhe orendive deri ne masen 50% te vlerës së demit për raste te paparashikuara, si dhe për raste të tjera të paparashikuara per emergjencat civile gjate vitit 2025.

b. " Shpenzime per marrjen e masave parandaluese, lehtesuese mbrojtese dhe rehabilituese ne objekte te ndryshme, nëpërmjet shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerezve " kod produkti 91707AG me vlere **6,000,000 lekë**.

Me kete shpenzim parashikojme sherbimin me mjete perballimin e nevojave per mbrojtje dhe permiresim te infrastruktures rrugore nga pasojat e rreshjeve ne rruge urbane dhe rurale.

Këto shërbime janë parashikuar të ndërhyjnë në rruget e qytetit dhe të njësite administrative fushore, për të bërë të mundur pastrimin e bores dhe materialeve te ndryshme në mënyre që të sigurohen kushtet e qarkullimit ne nje kohe sa me te shpejtë të njerezve dhe mjeteve.

Me keto shërbime jane parashikuar nderhyrjet per hapjen e rrugëve të njësive administrative Postribe- Pult -Shosh-Shale. Punimet e parashikuara jane zhbllokimi i rrugeve nga debora ne të gjithë aksin si dhe hapjen e rrugeve dhe riparimin e pasojave nga rreshqitjet e materialeve si gure, dhera etj.

Me këto masa do të sigurohet nderhyrja në kohë për mbajtjen në gjendje sigurie të rrugeve dhe per te bere të mundur krijimin e kushteve te levizjes te sigurte per banoret e ketyre zonave.

Sa me siper kerkojme nga ana juaj miratimin e propozimeve te paraqitura.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !

Me respekt

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**DREJTORI**

**Xhehnet DANI**

